



Departamenti Amerikan i Drejtësisë
Byroja Federale e Hetimeve

UDHËZUEZ për REAGIM ndaj KËRCËNIMIT dhe FRIKËSIMIT



KËRCËNIM I BËRË PERSONALISHT

KËRCËNIMI fizik i BËRË PERSONALISHT është atëherë kur jeni në rrezik të menjëhershëm për shkak të distancës së afërt të personit që po bën kërcënimin. Keni tre opsione:

- 1. Vraponi:** Identifikoni një rrugë shpëtimi. Hidhni çdo send që mund t'ju ngadalësojë. Nëse është e mundur, ndihmoni të tjerët të ikin. Telefononi 911.
- 2. Fshihuni:** Fshihuni larg vendit të kërcënimit. Mbyllni dyert me kyç ose bllokoni hyrjet. Vendoseni celularin tuaj në modalitet heshtjeje (duke përfshirë modalitetin e dridhjes) dhe rri në heshtje deri sa të përfundojë kërcënimin.
- 3. Përleshuni:** Përleshja duhet të jetë mjeti i fundit dhe vetëm në rastet kur jeta juaj është në rrezik të pashmangshëm. Përpuni ta neutralizoni kërcënimin. Veproni me sa më shumë agresion fizik që të mundeni.

KËRCËNIMI me gojë i BËRË PERSONALISHT, i llojit që nuk përbën rrezik të menjëhershëm për marrësin, ose synohet të realizohet më vonë.

- Shënojeni ose ndryshe regjistroni kërcënimin tamam siç u komunikua.
- Regjistroni sa më shumë detaje përshkruese të personit që bëri kërcënimin: emrin, pamjen, ngjyrën e lëkurës, gjininë, gjatësinë, peshën, ngjyrën e flokëve dhe të syve, zërin, veshjen ose çfarëdo veçori të tjera dalluese.
- Raportojeni kërcënimin te organet ligjzbatuese.

Nëse jeni në rrezik të menjëhershëm fizik, telefononi 911.

Nëse merrni një kërcënim, ju lutem kontaktoni zyrën tuaj vendore të FBI-së (listimet mund t'i gjeni në www.fbi.gov) ose dërgoni informacion përmes numrit 1-800-CALLFBI (ose 1-800-225-5324) ose përmes www.fbi.gov/tips

Gjithashtu mund të bëni një raportim anonim në FBI me telefon ose në internet.



KËRCËNIM PËRMES TELEFONIT

KËRCËNIMI TELEFONIK është kërcënim i marrë përmes telefonit. Duhet të përpuni të merrni sa më shumë informacion mbi telefonuesin dhe kërcënimin, përveç rasteve kur kërcënimin po ndodh diku afër ose mund t'u shkaktojë lëndime të menjëherëshme juve ose të tjerëve.

- Rrini i qetë dhe mos e mbyllni telefonin.
- Mbajeni telefonuesin sa më gjatë në telefon dhe përpuni të merrni informacion për të përcaktuar nëse kërcënimin është specifik, i vërtetë, ose nëse përbën rrezik të menjëhershëm për ju apo të tjerët.
- Nëse është e mundur, jepuni sinjal të tjerëve aty afër që të dëgjojnë dhe të njoftojnë organet ligjzbatuese.
- Kopjoni çdo informacion nga ekrani elektronik i telefonit.
- Shkruani formulimin e saktë të kërcënimit.
- Inçizojeni telefonatën nëse është e mundur.
- Jini të disponueshëm të diskutoni detajet me personelin e organeve ligjzbatuese.



KËRCËNIM PËRMES MESAZHIT ELEKTRONIK

KËRCËNIMI PËRMES MESAZHIT ELEKTRONIK është kërcënim i marrë nëpërmjet mesazheve të drejtpërdrejta, postës elektronike email, ose rrjetet sociale. Mund të përfshijë kërcënim për shantazh ose pasoja të pafavorshme nëse marrësi nuk bindet.

- Mos hapni mesazhin elektronik apo bashkëngjitje nga dërgues të panjohur.
- Mos komunikoni në rrjetet sociale me individë të panjohur ose të paftuar.
- Sigurohuni që parametrat tuaja të sigurisë të jenë vendosur në nivelin më të lartë të mbrojtjes.

Nëse merret një kërcënim elektronik:

- Mos e fshini mesazhin. Ekzaminimi forenzik mund të zbulojë detaje të rëndësishme.
- Lëreni mesazhin të hapur në kompjuter.
- Lajmëroni menjëherë organet ligjzbatuese.
- Printoni, fotografoni ose kopjoni mesazhin, rreshtin e temës së mesazhit, datën dhe orën.
- Ruajini të gjitha provat elektronike.



SULMET KIBERNETIKE

NJË SULM KIBERNETIK mund të kompromentojë pajisjen tuaj elektronike dhe mund të ekspozojë të dhëna personale.

- Përdorni frazëkalime të sigurta dhe mos përdorni të njëjtin frazëkalim për faqe të shumta interneti.
- Aktivizoni përditësimet automatike për aplikimet anti-virus dhe anti-malware.
- Aplikoni përditësimet e sistemit dhe softuerit sapo të bëhen të disponueshme.
- Aktivizoni autentikimin me dy faktorë.
- Rregullisht krijoni një kopje rezervë të të dhënave.

Nëse dyshoni se keni qenë viktimë e një sulmi kibernetik:

- Mos i fshini ose modifikoni sistemet e kompjuterit tuaj.
- Kontakttoni menjëherë institucionet tuaja financiare për të mbrojtur llogaritë tuaja nga vjedhja e identitetit.
- Ndryshoni frazëkalimet dhe monitoroni llogaritë për aktivitet të dyshimtë.



Departamenti Amerikan i Drejtësisë
Byroja Federale e Hetimeve

UDHËZUEZ për REAGIM ndaj KËRCËNIMIT dhe FRIKËSIMIT



Kë duhet të kontaktoj nëse përjetoj kërcënime apo frikësime: policinë vendore apo FBI-në?

- Nëse ju ose të tjerët jeni në rrezik fizik të menjëhershëm, telefononi policinë vendore në numrin 911.
- Nëse merrni një kërcënim që ka të bëjë me një krim federal, kontaktoni zyrën tuaj vendore të FBI-së (listimet tek www.fbi.gov) duke telefonuar në 1-800-CALLFBI (ose 1-800-225-5324) ose përmes www.fbi.gov/tips. Shembujt përfshijnë kërcënimet nga një agjent i një qeverie të huaj, nga krimi i organizuar ose nga një zyrtar qeveritar. Raporti juaj mund të jetë anonim.
- Jo të gjitha ngjarjet përmbushin kriteret apo caqet e vendosura për t'u hetuar nga FBI-ja. Nëse jeni viktimë e një ngjarje që nuk e arrin cakun e një krimi federal, mund t'ju duhet ta raportoni atë tek stacioni i policisë vendore tek ju. Juridiksionet vendore dhe shtetërore kanë caqe të ndryshme për hetimin e krimeve të dyshuara.



Çfarë mund të pres nëse intervistohem nga FBI-ja?

- Një agjent i FBI-së mund të takohet me ju tek një zyrë e FBI-së ose në një vend tjetër.
- FBI-ja do t'ju kërkojë të siguroni sa më shumë informacion që të jetë e mundur në lidhje me autorin e ngjarjes dhe detajet e kërcënimit që keni përjetuar.
- FBI-ja do t'ju kërkojë informacionin tuaj të kontaktit për t'ju kontaktuar nëse është e nevojshme.
- FBI-ja do përpiqet të ruajë identitetin dhe konfidencialitetin tuaj.
- Nëse është e përshtatshme, një Specialist i Viktimave i FBI-së mund të jetë i pranishëm gjatë intervistës për të ofruar informacion dhe mbështetje, ose mund t'ju kontaktojë me telefon ose me postë pas intervistës tuaj.



Cili është caku për FBI-në në hetimin e një ankese dhe/ose fillimin e një hetimi?

- FBI-ja është në gjendje të hetojë kërcënime që shkelin ligjin federal të SHBA-së dhe që nënkuptojnë lëndim ose rrezik për marrësin.
- Aftësia e qeverisë amerikane për të ndjekur penalisht individët për akuza të lidhura me kërcënimin, varet nga disa faktorë, si për shembull: cilësia e provave, aftësia për të identifikuar autorët që kryen veprimin, identifikimi i një komploti, dhe/ose aftësia për të arrestuar individët që kryen shkeljen.



Çfarë mund të pres nëse FBI-ja nis një hetim?

- Nëse FBI beson se mund të jetë kryer një krim federal, një ose më shumë agjentë specialë të FBI-së do të kryejnë një hetim. Si pjesë e hetimit, agjentët specialë do të mbledhin prova, proces i cili mund të përfshijë intervistimin tuaj dhe të viktimave të tjera.
- Gjithashtu, mund t'ju kërkohet të përshkruani para një jurie të madhe federale ngjarjen që përjetuat.
- Do të kryhet një hetim i plotë. Hetimi mund të zgjasë një kohë të gjatë deri sa të përfundojë, dhe ju nuk do të merrni përditësime lidhur me zhvillimet ditore të çështjes. Do të bëhet çdo përpjekje për t'ju informuar mbi ngjarjet kryesore të hetimit, si për shembull një arrestim ose ngritje e padisë. FBI-ja është e përkushtuar t'ju ofrojë këtë lloj informacioni para se të publikohet për publikun, kur është e mundur. Megjithatë, FBI duhet të jetë gjithmonë e kujdesshme për të mos zbuluar informacione të ndjeshme që mund të dëmtojnë hetimin ose mund të rrisin rrezikun ndaj organeve ligjzbatuese.
- Një Specialist i Viktimave i FBI-së do të jetë në dispozicion për t'u dhënë viktimave të identifikuar mbështetje, informacion, dhe referim për çdo burim lokal që mund të jetë i nevojshëm.

Edhe nëse raportimi i hollësive se si ju u kërcënuat apo frikësuat nuk rezulton në nisjen e një hetimi, ka të ngjarë të ndihmojë viktimat të tjera duke ndihmuar FBI-në të ndjekë kërcënimet dhe të identifikojë prirjet.